

**URDHËRESË**  
**Nr.7, datë 25.5.1990**

**PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E SË ARDHURËS NETO TË NDËRMARRJES**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**Neni 1**

E ardhura neto e ndërmarrjes përfaqëson diferencën ndërmjet arkëtimeve që sigurojnë ndërmarrjet nga shitja e produkteve nga punimet dhe shërbimet e kryera e nga qarkullimi i mallrave, pa të ardhurën neto të centralizuar të shtetit, dhe koston së plotë të tyre.

**Neni 2**

E ardhura neto e ndërmarrjes parashikohet në planin financiar të ndërmarrjes dhe përdoret:

a) 90 për qind për vetëfinancimin e zhvillimit të riprodhimit të zgjeruar të ndërmarrjes, si financimi i investimeve të planit, shlyerja e kredisë bankare afatgjatë, financimi i shtesës së normativës së mjeteve xhiruese, pagimi i primit të sigurimit të pasurisë nga fatkeqësitë e natyrës dhe dëmet nga fuqitë madhore, si dhe për krijimin e fondit të veçantë të ndërmarrjes dhe të fondeve të tjera që përcaktohen me dispozita të veçanta.

b) 10 për qind të derdhet në buxhetin e shtetit si levë kontrolli mbi fondet themelore në përdorim.

**Neni 3**

Kur ndërmarrja e planifikon me rritje të ardhurën neto të saj faktit të një viti më parë dhe realizon ose e tejkalon atë, me përjashtim të rasteve kur kjo shtesë vjen si rezultat i vënies në shfrytëzim të kapaciteteve të reja prodhuese, ka të drejtë që deri në gjysmën e diferencës ndërmjet dy periudhave të përdorë për shpërblimin e punonjësve, sipas kritereve të caktuara.

Në ndërmarrjet që caktohet një plan më i vogël për të ardhurën e saj neto ndaj faktit të periudhës së mëparshme, për të shpërblyer punonjësit sipas rregullit të mësipërm përdoret vetëm deri në 50 për qind e tejkalimit.

Ndërmarrjet e planifikuara me humbje, për rastet e pakësimit ose të tejkalimit të humbjes, gëzojnë të drejta dhe detyrime analoge.

**Neni 4**

E ardhura neto e ndërmarrjes dhe fondet e tjera të krijuara e të papërdorura mbarte nga njëri vit në tjetrin në llogaritë përkatëse të ndërmarrjet pranë bankës.

**Neni 5**

Ndërmarrja derdh në buxhetin e shtetit pjesën e planifikuar të së ardhurës neto të saj, pavarësisht nga shkalla e realizimit ose nga gjendja financiare, brenda afateve që cakton Ministria e Financave.

**Neni 6**

Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 22.4.1968 "Për përdorimin e fitimit në ndërmarrjet shtetërore", shfuqizohet.

Kjo urdhëresë hyn në fuqi më 1.1.1991.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**ADIL ÇARÇANI**